



TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori I 2024

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE.....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	8
3. Treguesit e e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare	9
4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë	11
5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë.....	11

I. HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e parë të vitit 2024, si edhe krahasimet me tremujorin e katërt të vitit 2023 dhe me tremujorin e parë të vitit 2023, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e parë të vitit 2024 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (23 subjekte):**
 1. Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
 3. ALOPOST sh.p.k.
 4. BIPEX sh.p.k.
 5. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
 6. DHL International (Albania) sh.p.k.
 7. Elite Post sh.p.k.
 8. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
 9. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
 10. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
 11. Greenposta shpk
 12. INTEX COURIER sh.p.k.
 13. IPOST sh.p.k.
 14. Milsped Albania sh.p.k.
 15. Mr. COURIER sh.p.k.
 16. POSTA JONË sh.p.k.
 17. POSTMAN sh.p.k

18. T.N.T Express Albania sh.p.k.
19. Top Post sh.p.k.
20. Ultra C.E.P. sh.p.k.
21. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
22. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
23. Youth Albania Professional Services (YAPS);

Gjatë periudhës, nga tremujori i katërt i vitit 2023 deri në tremujorin e parë të vitit 2024, nuk ka pasur subjekte të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 21 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.04.2024

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 rezultojnë 6,133,357 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T1_2023	T2_2023	T3_2023	T4_2023	T1_2024	Ndryshim T1_2024/ T4_2023	Ndryshim T1_2024/ T1_2023
Posta Shqiptare sh.a								
1	Shërbim Universal Postar							
1.1	Postë brenda vendit	5,351,099	3,679,866	4,098,479	4,522,704	4,727,732	5%	-12%
1.2	Postë ndërkombëtare	184,390	188,482	186,888	183,248	158,687	-13%	-14%
1.3	Totali 1.1+1.2	5,535,489	3,868,348	4,285,367	4,705,952	4,886,419	4%	-12%
2	Shërbim jouniversal postar							
2.1	Postë brenda vendit	92,252	164,019	72,173	73,570	86,517	18%	-6%
2.2	Postë ndërkombëtare	146	631	532	574	233	-59%	60%
2.3	Totali 2.1+2.2	92,398	164,650	72,705	74,144	86,750	17%	-6%
3	Shërbim ekspres							
3.1	Ekspres brenda vendit	126,129	126,802	129,033	109,818	117,001	7%	-7%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	3,883	3,954	1,329	3,234	3,005	-7%	-23%
3.3	Totali 3.1+3.2	130,012	130,756	130,362	113,052	120,006	6%	-8%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare								
4	Shërbim JoUniversal Postar							
4.1	Postë brenda vendit	196,289	199,271	153,457	154,541	90,551	-41%	-54%
4.2	Postë ndërkombëtare	2,819	4,295	4,304	23,192	1,764	-92%	-37%
4.3	Totali 4.1+4.2	199,108	203,566	157,761	177,733	92,315	-48%	-54%
5	Shërbim ekspres							
5.1	Ekspres brenda vendit	712,332	679,269	689,710	825,031	825,844	0.1%	16%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	63,387	104,757	119,519	123,551	136,049	10%	115%
5.3	Totali 5.1+5.2	775,719	784,026	809,229	948,582	961,893	1%	24%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,732,726	5,151,346	5,455,424	6,019,463	6,147,383	2%	-9%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pësuar rënie në masën 12% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe rritje në masën 4% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T4 2023,. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur një rënie krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm në masën 12%, dhe një rritje në masën 5% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm, ndërsa zëri **Postë Ndërkombëtare** ka një rënie në nivelin 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe në nivelin 13% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në nivelin 6% dhe një rritje në nivelin 17% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023. Në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit**. Ndërsa zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rritje me 60% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe rënie me 59% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 8% dhe rritje me 6% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023. Edhe shërbimi **Ekspres brenda vendit** ka pasur rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 7% dhe rritje në masën 7% në krahasim me 3 mujorin e mëparshëm T4 2023, ndërkohë që zëri **Ekspres Ndërkombëtar** ka pësuar rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 23%, dhe në masën 7% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023.

Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rënie në 3-mujorin e I 2024 në krahasim me 3-mujorin e IV të 2024 në masën 48% dhe në masën 54% në krahasim me 3-mujorin I të vitit të kaluar. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur rënie në krahasim me 3-mujorin e IV të 2023 në masën 41% dhe në masën 54% krahasuar me 3-mujorin I të vitit të kaluar. Edhe zëri **Postë ndërkombëtare** ka pasur një rënie në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023 në masën 92% dhe 37% në krahasim me 3-mujorin I të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka pasur rritje në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar T4 2023 në masën 1%, dhe në masen 24% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka pësuar një rënie shumë të vogël në masën 0.1% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rritje në masën 16% krahasuar me vitin e kaluar. Zëri i shërbimit **Ekspres ndërkombëtar** ka pasur rritje krahasuar si me 3-mujorin e mëparshëm T4 2023 ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, përkatësisht në masat 10% dhe 115%.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1 2024

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,093,175	83%
<i>Of. e tjerë</i>	1,054,208	17%
Totali	6,147,383	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rritje në objektet postare në T1_2024 krahasuar me T4_2023 për Postën Shqiptare dhe një rënie për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rënie të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare dhe rritje për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T1_2024

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,886,419	179,065	1,081,899	6,147,383
79%	3%	18%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 79%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 18% dhe shërbimi jo universal 3 %.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T1_2024 me periudhën T4_2023 vërehet që kemi një rritje në masën 2% në volumin total të shërbimeve postare. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet një rënie në masën 9%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T1 2024

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,727,732
Postë ndërkombëtare	158,687
Totali	4,886,419

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T1 2024, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,886,419 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 97% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 3% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,869,797 shërbime për objekte të thjeshta dhe 857,935 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 26,256 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 132,431 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rritje e shërbimit universal postar në T1_2024 krahasuar me T4_2023, me 4%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_1 2024	Pjesa tregut T_1 2023
Shërbim universal postar	4,886,419	95.9%	96.1%
Shërbim jo universal postar	86,750	1.7%	1.6%
Shërbim ekspres	120,006	2.4%	2.3%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 95.9%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2.4% dhe nga shërbimi jo universal postar 1.7%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rritje të vogël Shërbimit jo universal postar dhe rënie të vogël të Shërbimit ekspres.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rritje e shërbimit universal, atij jo universal dhe shërbimit ekspres në T1_2024 krahasuar me T4_2023.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2024	Pjesë tregu T1_2023
P.Sh	86,750	48%	32%
Of. e tjerë	92,315	52%	68%
Totali	179,065	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T1_2024 krahasuar me T4_2024 kanë pësuar rënie në total në masën 29% ku vërehet një rritje prej 17% për Postën Shqiptare, dhe një rënie me 48% për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T1 2024 përbëhet nga 177,068 objekte brenda vendit dhe 1,997 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të parë të vitit 2024, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2023, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T1_2024

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T1_2024	Pjesë tregu T1_2023
P. Shqiptare	120,006	11%	14%
Of. e tjerë	961,893	89%	86%
Totali	1,081,899	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T1_2024 ka pësuar rritje në krahasim me T4_2023 në masën 2% dhe me 19% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndikimin në këtë rritje e kane si Ofruesit e tjerë, ashtu dhe PSH.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 942,845 objekte postare ose 87% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 139,054 objekte postare ose 13% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 107,834 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 31,220 objekte.